FLETORJA ZYRTARE

E

REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Nr. 4	2003	Shkurt

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Vendim i KM nr. 67, datë 10.1.2003	Për miratimin e strategjisë së punësimit dhe të formimit profesional……	119
Vendim i GjK nr. 1, datë 31.1.2003	Me objekt shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën të neneve 6 e 30 të ligjit nr. 8701, datë 1.12.2000 "Për lojërat e fatit, kazinotë dhe hipodromet"	119
Vendim i GjK nr. 2, datë 31.1.2003	Me objekt shfuqizimin si antikushtetues të ligjit nr. 355, datë 21.11.1946 "Mbi shlyerjen e huave që kanë lindur para datës 29 nëntor 1944"……	123
Rregullore e Bankës së Shqipërisë	Për ekspertët kontabël të autorizuar të bankave…….	126

V E N D I M
Nr. 67, datë 10.1.2003

PËR MIRATIMIN E STRATEGJISË SË PUNËSIMIT DHE TË FORMIMIT PROFESIONAL

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 4 të ligjit nr. 7995, datë 20.9.1995 "Për nxitjen e punësimit", me ndryshimet përkatëse, me propozimin e Ministrit të Punës dhe të Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Miratimin e strategjisë së punësimit dhe të formimit profesional, sipas tekstit, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

V E N D I M
Nr. 1, datë 31.1.2003

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Fehmi Abdiu	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese	
Zija Vuci	Anëtar i	""
Gjergj Sauli	Anëtar i	""
Alfred Karamuço	Anëtar i	""
Kristofor Peçi	Anëtar i	""
Kujtim Puto	Anëtar i	""
Sokol Sadushi	Anëtar i	""
Petrit Plloçi	Anëtar i	""

me sekretare Arbenka Lalica, më datën 30.1.2003, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore, me dyer të hapura, çështjen nr. 216/6 Akti, që i përket:

KËRKUES: GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR TIRANË
SUBJEKTE TË INTERESUARA:
1. KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, përfaqësuar nga zoti Viktor Gumi, me autorizim.
2. KËSHILLI I MINISTRAVE, në mungesë.
3. MINISTRIA E FINANCAVE, në mungesë.
4. DREJTORIA E PËRGJITHSHME E TATIMEVE, në mungesë.
5. "BOAR", sh.p.k., përfaqësuar nga zoti Bardhyl Meçe, president i shoqërisë.

OBJEKTI: Shfuqizimi i neneve 6 e 30 të ligjit nr. 8701, datë 1.12.2000 "Për lojërat e fatit, kazinotë dhe hipodromet", si të papajtueshëm me Kushtetutën.
BAZA LIGJORE: Nenet 131/a e 145/2 të Kushtetutës.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, në vendimin për dërgimin e çështjes në Gjykatën Kushtetuese, ka parashtruar këto shkaqe për papajtueshmërinë me Kushtetutën të neneve 6 e 30 të ligjit të mësipërm:

- Zbatimi i neneve 6 e 30 të ligjit nr. 8701, datë 1.12.2000 "Për lojërat e fatit, kazinotë dhe hipodromet", vjen në kundërshtim me dispozitat e Kushtetutës, pasi rëndon pozitën financiare të

shoqërisë;

- Dispozitat e kundërshtuara vijnë në kundërshtim me nenin 155 të Kushtetutës, sepse, me to, ligjit të mësipërm i jepet fuqi prapavepruese.

Përfaqësuesi i subjektit të interesuar, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, parashtroi se neni 30 i ligjit të mësipërm nuk vjen në kundërshtim me dispozitat e Kushtetutës, sepse nga formulimi i tij del qartë se organizatori nuk detyrohet të paguajë shumën e parashikuar në nenin 6 pa mbaruar afati 10-vjeçar i lejes së dhënë.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes, Petrit Plloçi, përfaqësuesin e kërkuesit, të subjekteve të interesuara dhe shqyrtoi çështjen,

V Ë R E N:

"BOAR-FUAT" sh.p.k., që ushtron veprimtarinë e organizimit të lojës së fatit – bingo në qytetin e Librazhdit, ka paraqitur padi në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor, Tiranë, kundër palës së paditur, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve me objekt anulimin e aktit administrativ – aktbllokimin datë 18.3.2002, të nxjerrë nga pala e paditur.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Tiranë, ka arritur në përfundimin se për zgjidhjen e kësaj çështjeje duhet të zbatohet ligji nr.8701, datë 1.12.2000 "Për lojërat e fatit, kazinotë dhe hipodromet". Gjykata, duke çmuar se nenet 6 e 30 të këtij ligji nuk janë në pajtim me Kushtetutën, në bazë të nenit 145/2 të saj, ka pezulluar gjykimin dhe ia ka dërguar çështjen Gjykatës Kushtetuese.

Në përfundim të shqyrtimit të çështjes, Gjykata Kushtetuese bashkohet me mendimin e shprehur nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Tiranë, për papajtueshmërinë me Kushtetutën të nenit 30 të ligjit të mësipërm, për këto arsye:

Neni 155 i Kushtetutës parashikon se taksat, tatimet dhe detyrimet financiare, kombëtare e vendore, lehtësimi ose përjashtimi prej tyre i kategorive të caktuara të paguesve, si dhe mënyra e mbledhjes së tyre caktohen me ligj dhe se, në këto raste, ligjit nuk mund t'i jepet fuqi prapavepruese.

Për sa më sipër, çështja që shtrohet për zgjidhje është nëse ligji i atakuar, përfshihet në kategorinë e ligjeve të parashikuara në nenin 155 të Kushtetutës. Për këtë qëllim, duhet përcaktuar nëse pagesa që kërkon neni 6 i ligjit të vitit 2000, si kusht për dhënien e lejes, do të konsiderohet taksë, tatim apo detyrim tjetër financiar, kombëtar e vendor.

Sipas nenit 9 të ligjit të sipërpërmendur të vitit 2000, fitimet që organizatori i lojërave të fatit realizon nga ushtrimi i veprimtarisë së vet, janë të tatueshme, në bazë të dispozitave ligjore në fuqi. Pagesa që kërkon neni 6 është pagesë fikse dhe, duke qenë e tillë, nuk është tatim. Përveç kësaj, pagesa që kërkon kjo dispozitë nuk është as taksë, sepse për këtë lloj veprimtarie të palës kërkuese, në ligjin nr. 8435, datë 28.l2.1998 "Për sistemin e taksave", parashikohet një taksë, e cila është e ndryshme nga pagesa që kërkon neni 6 i ligjit të vitit 2000. Konkretisht pika 17 e nenit 2 parashikon se në taksat kombëtare, ndërmjet të tjerash, bën pjesë edhe "taksa e regjistrimit për ushtrimin e llotarive, të konkurseve parashikuese dhe lojërave të fatit", ndërsa sipas nenit 6/I/nj, ku caktohet niveli i taksave, kjo lloj takse është 50 mijë lekë në vit. Ndërsa, ligji nr. 8977, datë 12.12.2002 "Për sistemin e taksave në Republikën e Shqipërisë", si dhe ligji nr. 8982, datë 12.12.2002 "Për sistemin e taksave vendore", në dispozitat respektive, ku parashikojnë llojet e taksave, për veprimtarinë që ushtron pala kërkuese, nuk parashikojnë ndonjë taksë. Për pasojë, detyrimi për pagimin e shumës 10 milionë lekë, si kusht për marrjen e lejes për ushtrimin e veprimtarisë, duhet kategorizuar si detyrim financiar, pra në kategorinë e tretë të detyrimeve që parashikon neni 155 i Kushtetutës.

Çështja tjetër që duhet të trajtohet është nëse neni 30 i ligjit të vitit 2000, i jep këtij ligji fuqi prapavepruese.

Lidhur me nocionin e fuqisë prapavepruese doktrina ka pranuar se kjo është e pranishme në rastet kur një normë ligjore zbatohet për gjëra tashmë të vendosura në të kaluarën. Në aspektin kushtetues, ligji me fuqi prapavepruese është i kundërshtueshëm nëqoftëse cenon të drejtat e fituara me ligjet ekzistuese ose krijon një detyrim të ri, përsa u përket transaksioneve të shkuara.

Për këtë rast rezulton se palës kërkuese i është dhënë leja e ushtrimit të veprimtarisë në bazë të ligjit të vitit 1994, për një afat 10-vjeçar dhe ky afat nuk ka përfunduar. Në bazë të ligjit të vitit 1994,

të përmendur më sipër, subjektet që ushtrojnë këtë veprimtari nuk kishin ndonjë detyrim për të paguar, si kusht për marrjen e lejes, ndërkohë që sipas nenit 6 të ligjit të vitit 2000 për marrjen e lejes, organizatori paguan një shumë prej 10 milionë lekësh. Këtë pagesë, neni 30 i ligjit të vitit 2000, e kërkon edhe për lejet e dhëna në bazë të ligjit të vitit 1994, afati i të cilave nuk ka përfunduar. Në këtë mënyrë, neni 30 i ligjit nr. 8701, datë 1.12.2000, "Për lojërat e fatit, kazinotë dhe hipodromet", duke parashikuar zbatimin e këtij ligji të ri edhe për lejet e dhëna me ligjin e mëparshëm, i jep këtij ligji fuqi prapavepruese, gjë që vjen në kundërshtim me nenin 155 të Kushtetutës.

Në këto kushte, neni 30 i ligjit të mësipërm duhet të shfuqizohet, si i papajtueshëm me Kushtetutën.

Lidhur me nenin 6 të ligjit të mësipërm, Gjykata Kushtetuese arrin në përfundimin se kjo dispozitë, në vetvete, nuk vjen në kundërshtim me Kushtetutën. Për pasojë, sipas kësaj dispozite kërkesa duhet të rrëzohet.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 68 e 72 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", me shumicë votash

V E N D O S I:

- Shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën, të nenit 30 të ligjit nr. 8701, datë 1.12.2000 "Për lojërat e fatit, kazinotë dhe hipodromet";
- rrëzimin e kërkesës për shfuqizimin e nenit 6 të ligjit nr. 8701, datë 1.12.2000 "Për lojërat e fatit, kazinotë dhe hipodromet".
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

MENDIMI I PAKICËS

Kam mendim të kundërt me vendimin e shumicës, që ka arritur në përfundimin për papajtueshmërinë me Kushtetutën të nenit 30 të ligjit nr. 8701, datë 1.12.2000 "Për lojërat e fatit, kazinotë dhe hipodromet". Ky nen nuk ka përmbajtje antikushtetuese dhe, si i tillë, nuk duhet të shfuqizohet.

Argumenti i vetëm për pakushtetutshmërinë e këtij neni është se ai i jep ligjit fuqi prapavepruese dhe për këtë bie në kundërshtim me nenin 155 të Kushtetutës.

Për të arritur në një përfundim të drejtë për përmbajtjen e nenit 30 të ligjit dhe nëse zbatimit të tij i jepet ose jo fuqi prapavepruese, është e nevojshme të analizohet kjo dispozitë në lidhje me dispozitat e tjera të ligjit dhe me qëllimin e tij. Neni 30 ka këtë përmbajtje: "Ripërtëritja vjetore e lejeve për licencat ekzistuese, pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, bëhet sipas kritereve të përcaktuara në këtë ligj".

Me këtë formulim ligjvënësi ka patur si qëllim të ruajë edhe për të ardhmen konceptin e ripërtëritjes vjetore të lejeve, të përcaktuar në pikën 2 të nenit 8 të ligjit të mëparshëm nr. 7871, datë 9.11.1994 "Për lojërat e fatit, kazinotë dhe hipodromet", shfuqizimi i të cilit parashikohet në nenin 31 të ligjit në fuqi. Pra, ky ligj para se të bëjë shfuqizimin e ligjit të mëparshëm ka marrë prej tij kriterin e përtëritjes vjetore, veprim ky që kryhet pa pagesë nga subjekti i licencuar.

Ky kriter ligjor i përtëritjes vjetore të lejeve pa shpërblim, i miratuar nga ligji në fuqi, ka si qëllim të ruajë vazhdimësinë e licencave, por pa dëmtuar subjektet e licencuara më parë. Kështu, subjekti që ka përfituar licencën sipas ligjit të mëparshëm, me afat 10-vjeçar, kundrejt detyrimit monetar të caktuar, do të vazhdojë ta ruajë këtë të drejtë deri në fund të afatit, me kusht që nga ana e shtetit të bëhet kontrolli i përtëritjes vjetore. Duke qenë se ky kontroll nuk shoqërohet me detyrim monetar, i cili është paguar një herë kur është marrë licenca, nuk mund të arrihet në përfundimin se neni 30 i ligjit, ka fuqi prapavepruese.

Përfundimi për pakushtetutshmërinë e nenit 30 vetëm për shkak të fuqisë prapavepruese, nuk

është i bazuar edhe për arsye të tjera. Të njëjtën përmbajtje ka edhe neni 6 i ligjit, që parashikon se leja për organizimin e lojërave të fatit jepet për një periudhë 10-vjeçare, për marrjen e të cilës, organizatori paguan një shumë prej 10 milionë lekësh. Edhe për këtë nen është kërkuar shfuqizimi i tij si antikushtetues për të njëjtin shkak, atë të fuqisë prapavepruese të tij, por Gjykata Kushtetuese nuk e vlerëson të tillë. Po t'i qëndrohet argumentit që përdoret për ta quajtur antikushtetues nenin 30, e njëjta gjë mund të thuhet edhe për nenin 6, si edhe për nenin 11, i cili parashikon ripërtëritjen e lejës kundrejt pagesës prej gjysmës së shumës së parashikuar në nenin 6, për afate 5-vjeçare. Po të bëhet interpretimi i përmbajtjes së këtyre neneve nën frymën e interpretimit që shumica i bën nenit 30 të ligjit, del se, si rezultat i fuqisë prapavepruese të tyre, dëmi që u shkaktohet subjekteve të licencuara me ligjin e mëparshëm është jo vetëm real, por edhe shumë herë më i madh, në raport me nenin 30, i cili parashikon ripërtëritjen vjetore pa shpërblim.

Mendoj, se për të bërë një interpretim sa më të saktë të këtyre dispozitave, krahasuar me kërkesat e nenit 155 të Kushtetutës, duhet nxjerrë në dukje qëllimi që ka ligji, i përcaktuar ky edhe në nenin 30, përmbajtja e të cilit, po të shihet në lidhje me dispozitat e tjera, synon që marrëdhëniet e krijuara nga veprimtaria e subjekteve të licencuara me ligjin e mëparshëm, të vazhdojnë të rregullohen nëpërmjet ligjit në fuqi, por pa detyrimin për të paguar shumën e caktuar për marrjen e licencës, e cila është paguar një herë për një afat 10-vjeçar.

Në një përfundim të tillë arrihet edhe nga fakti se detyrimi për të paguar për marrjen e licencës është një detyrim financiar që bëhet në një kohë të caktuar (në marrjen e licencës) dhe konsiderohet i paguar brenda periudhës 10-vjeçare. Duke qenë i një natyre të tillë, në dallim nga taksat e tatimet për të cilat ka kritere të veçanta, ky detyrim paguhet vetëm një herë.

Përderisa neni 30 i ligjit nuk krijon një detyrim të ri për ato subjekte që kanë fituar më parë të drejtën e marrjes së licencës, në rastin e një konflikti eventual, gjykata që shqyrton çështjen do ta zgjidhë atë në përshtatje me kërkesat e kësaj dispozite dhe qëllimin e ligjit, i cili e konsideron të pambaruar afatin 10-vjeçar. Në këto kushte, gjykata që shqyrtonte çështjen, nëpërmjet interpretimit të ligjit, duhet ta zgjidhte vetë atë pa qenë nevoja t'i drejtohej Gjykatës Kushtetuese.

Duke e parë këtë problem në një aspekt më të gjerë se përmbajtja e dispozitës së atakuar, mund të mendohet se kjo e fundit është antikushtetuese për shkak të paqartësisë dhe të kontradiktave që ka me dispozita të tjera të ligjit. Ndonëse ky aspekt nuk trajtohet në vendimin e shumicës, duke u mjaftuar vetëm me argumentin për fuqinë prapavepruese, vlen të theksohet se në rastin konkret nuk evidentohet antikushtetutshmëria as në këtë drejtim. Kjo për faktin se dispozita ligjore mund të konsiderohet antikushtetuese kur paqartësitë ose kontradiktat që ka, janë të tilla që bëjnë të pamundur zbatimin praktik të saj. Por, përderisa kjo dispozitë zbatohet duke iu bërë interpretimi në përshtatje me qëllimin e ligjit që rregullon këtë veprimtari, siç u përmend më lart, antikushtetutshmëria e nenit 30 nuk gjen mbështetje as në këtë aspekt.

Përfundimisht mendoj se zgjidhja më e drejtë do të ishte lënia në fuqi e nenit 30 duke argumentuar se përmbajtja e tij nuk vjen në kundërshtim me Kushtetutën, sepse nuk i është dhënë fuqi prapavepruese.

ANËTAR
K. Peçi

V E N D I M
Nr. 2, datë 31.1.2003

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Fehmi AbdiuKryetar i Gjykatës Kushtetuese,
Zija VuciAnëtar i“““
Gjergj SauliAnëtar i“““
Alfred KaramuçoAnëtar i“““

Kristofor PeçiAnëtar i “”
Kujtim PutoAnëtar i “”
Sokol SadushiAnëtar i “”
Petrit PlloçiAnëtar i“”

me sekretare Arbenka Lalica, më datën 30.1.2003, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura, çështjen nr.172/3 Akti, që i përket:

KËRKUES: GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR DURRËS
SUBJEKTE TË INTERESUARA:
1. KRISANTHI QIRKO, përfaqësuar nga avokat Rustem Syziu.
2. HYSEN, BETIM, ADILE MYSHKETA; LIRI DAKOLI e DHURATA SARAÇI, përfaqësuar nga avokat Rifat Aliu.

OBJEKTI: Shfuqizimi si antikushtetues i ligjit nr.355, datë 21.11.1946 “Mbi shlyerjen e huave që kanë lindur para datës 29 nëntor 1944”.
BAZA LIGJORE: Nenet 131/a e 145/2 të Kushtetutës.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, në vendimin për dërgimin e çështjes Gjykatës Kushtetuese, ka parashtruar ndërmjet të tjerash, këto shkaqe për antikushtetutshmërinë e ligjit të mësipërm:
- Nëpërmjet dispozitave të ligjit nr. 355, datë 21.11.1946 “Mbi shlyerjen e huave që kanë lindur para datës 29 nëntor 1944”, shteti ka ndërhyrë në të drejtën e pronës të personave privatë, të parashikuar në nenin 41 të Kushtetutës.
- Ligji nr. 355, datë 21.11.1946, bie në kundërshtim edhe me parimet kushtetuese të sanksionuara në nenet 3 e 11 të Kushtetutës.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Petrit Plloçi, përfaqësuesit e subjekteve të interesuara dhe shqyrtoi çështjen

V Ë R E N:

Paditësja Krisanthi Qirko ka ngritur padi në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës kundër të padituve Hysen, Betim e Adile Myshketa, Liri Dakoli, Dhurata Saraçi, me objekt – detyrimin për kthimin e një shume parash.
Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, ka konstatuar, se detyrimi ndërmjet palëve ka lindur që në vitin 1938 dhe se zgjidhja e konfliktit të mësipërm, bazohet në efektet e ligjit nr. 355, datë 21.11.1946 “Mbi shlyerjen e huave që kanë lindur para datës 29 nëntor 1944”.
Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, duke çmuar se ligji i mësipërm është në fuqi dhe duke vënë në dyshim kushtetutshmërinë e këtij ligji, në bazë të nenit 145/2 të Kushtetutës, ka pezulluar gjykimin dhe ia ka dërguar çështjen Gjykatës Kushtetuese.
Lidhur me shkaqet e antikushtetutshmërisë së ligjit të kundërshtuar, në vendimin e mësipërm, gjykata e rrethit ka parashtruar se me anën e këtij ligji, në nenin 1 të të cilit parashikohet, se të gjitha huatë që kanë lindur para datës 29 nëntor 1944 shlyhen krejt, shteti ndërhyn në të drejtat e individit, se nëpërmjet këtij ligji, shteti merr përsipër të ndryshojë pasojat juridike që kanë lindur si rezultat i marrëdhënieve juridike të krijuara ndërmjet palëve të caktuara, pa qenë vetë palë në këto marrëdhënie. Sipas Gjykatës, me anën e ligjit të kundërshtuar, shteti u cenon individëve të drejtën e pronës si një e drejtë themelore. Konkretisht, gjykata ka vlerësuar se ligji i mësipërm bie në kundërshtim me nenet 3, 11 e 41 të Kushtetutës.
Gjykata Kushtetuese, lidhur me pretendimin se ligji i kundërshtuar është në fuqi, nuk mund të bashkohet me opinionin e shprehur nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës.

Në nenin 132 pika 1 të Kushtetutës është parashikuar, se Gjykata Kushtetuese ka vetëm të drejtën e shfuqizimit të akteve që shqyrton. Përveç kësaj, kontrolli kushtetues i ligjeve ose akteve të

tjera normative shtrihet vetëm mbi ato burime të të drejtës që aktualisht janë në fuqi. Megjithatë, në disa raste, këtij kontrolli i nënshtrohen edhe norma juridike të shfuqizuara, kur këto, si pjesë e të drejtës pozitive, duhet të zbatohen për rregullimin e pasojave juridike, që zgjasin në kohë dhe janë të lidhura më ekzekutimin periodik ose me afat të detyrimeve juridike civile, që rrjedhin nga marrëdhënie juridike të krijuara në kohën e ligjit të shfuqizuar.

Duke iu referuar çështjes objekt gjykimi dhe duke e parë atë në dritën e dispozitave të lartpërmendura, Gjykata Kushtetuese arrin në përfundimin, se kërkesa e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës është pa objekt, pasi ligji i kundërshtuar prej kësaj gjykate për papajtueshmëri me Kushtetutën ka rënë nga fuqia.

Ligji i mësipërm, i atakuar si antikushtetues, ka pasur për qëllim të shlyejë detyrimet vetëm për një periudhë të caktuar dhe vetëm ato detyrime, që kishin të bënin me kontratat e huave. Me plotësimin e këtij qëllimi ky ligj ka rënë nga fuqia. Përveç kësaj, ky ligj, hyn në kategorinë e ligjeve të posaçme. Për pasojë, duke qenë i tillë, në rastet kur ligji pasardhës është i përgjithshëm, nuk aplikohet rregulli i abrogimit (i shfuqizimit nga ligjvënësi). Këtu bën përjashtim vetëm rasti kur ligjvënësi shpreh një vullnet të kundërt, domethënë, në rastet kur me ligjin e përgjithshëm që nxjerr pas ligjit të posaçëm, ligjvënësi ka për qëllim të eliminojë ose të rregullojë pasojat që ka sjellë ligji i posaçëm, gjë që në rastin në shqyrtim nuk ka ndodhur.

Në këto kushte, Gjykata Kushtetuese, çmon se ligji objekt - kërkese ka rënë vetvetiu nga fuqia për shkak se e ka realizuar qëllimin e tij. Nga ana tjetër, ky ligj është edhe i pazbatueshëm pasi aktualisht, asnjë pasojë e krijuar prej tij nuk ka mbetur pa u ezauruar.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 68 e 72 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, njëzëri,

V E N D O S I:

- Rrëzimin e kërkesës;
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

RREGULLORE
PËR EKSPERTËT KONTABËL TË AUTORIZUAR TË BANKAVE

Neni 1
Dispozita të përgjithshme

1.1 Në këtë rregullore përcaktohen :

- kriteret dhe procedurat për miratimin e ekspertëve kontabël të autorizuar të emëruar nga bankat;
- fusha e veprimtarisë, forma dhe përmbajtja e kontrollit dhe e raporteve të kontrollit të bankës nga ekspertët kontabël të autorizuar.

1.2 Bazën ligjore të kësaj rregulloreje e përbëjnë: ligji nr. 8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë”, neni 43 gërma c, ligji nr. 8365, datë 2.7.1998 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, kreu VI “Llogaritë, kontrolli, inspektimi dhe mënyra e raportimit” dhe ligji nr. 7638, datë 19.11.1992 “Për shoqëritë tregtare”.

1.3 Subjekte të kësaj rregulloreje janë bankat dhe degët e bankave të huaja, të licencuara nga

Banka e Shqipërisë për të kryer aktivitet bankar në Republikën e Shqipërisë, që në vijim do të quhen "bankë".

1.4 Për efekt të kësaj rregulloreje, "Kontrolli i ushtruar nga eksperti kontabël i autorizuar " përfshin :

a- kontrollin e raporteve bazë financiare, që në vijim quhen "raporte financiare" që përgatiten nga banka në përputhje me "Standardet ndërkombëtare të kontabilitetit (IASs)" përveç kur është parashikuar ndryshe në ligjin "Për kontabilitetin" dhe në "Manualin e kontabilitetit bankar". Raportet bazë financiare përgatiten për botim dhe shërbejnë për përdorim të përgjithshëm;

b- vlerësimin e pasqyrave financiare me karakter specifik të përgatitura nga banka në përputhje me aktet nënligjore të Bankës së Shqipërisë;

c- vlerësimin e mjaftueshmërisë dhe të cilësisë të akteve nënligjore dhe të procedurave të bankës, dhe zbatimin e tyre.

Neni 2

Dokumentacioni i kërkuar

2.1 Jo më vonë se muaji korrik i çdo viti, banka njofton Bankën e Shqipërisë për ekspertin kontabël të zgjedhur nga vetë banka, për kryerjen e kontrollit të raporteve financiare vjetore të vitit financiar në vazhdim, dhe paraqet kërkesën për miratim në Bankën e Shqipërisë.

2.2 Banka e Shqipërisë miraton ekspertin kontabël të autorizuar, kur kandidati për ekspert kontabël i paraqitur për miratim është "Shoqëri e ekspertëve kontabël të autorizuar", e regjistruar në listën e IEKA-s, dhe kur plotësohen kushtet e përcaktuara në këtë rregullore.

2.3 Për miratimin e ekspertit kontabël të autorizuar, banka paraqet në Bankën e Shqipërisë, dokumentacionin si më poshtë:

- vendimin e asamblesë së aksionerëve të bankës ose të organeve të deleguara prej saj, për emërimin e ekspertit kontabël të autorizuar;
- programin e kontrollit;
- letrën e angazhimit të paraqitur nga shoqëria e ekspertëve kontabël;
- dokumentin që vërteton se shoqëria e ekspertëve kontabël të autorizuar është e regjistruar në listën e IEKA-s;
- dokumentin që vërteton se shoqëria e ekspertëve kontabël të autorizuar, ka jo më pak se 5 vjet eksperiencë në fushën e ekspertizës kontabël.

2.4 Dokumentacioni paraqitet në gjuhën shqipe, në origjinal ose në fotokopje të noterizuar. Kur dokumentacioni është në gjuhë të huaj, origjinal ose fotokopje e noterizuar, do të jetë i shoqëruar nga përkthimi në gjuhën shqipe i noterizuar.

Neni 3

Miratimi ose refuzimi i ekspertit kontabël

3.1 Banka e Shqipërisë, brenda një muaji nga data e paraqitjes së dokumentacionit të plotë të kërkuar sipas nenit 2 të kësaj rregulloreje, bën miratimin ose refuzimin e emërimit të ekspertit kontabël të autorizuar të bankës. Në rast refuzimi, jepen me shkrim arsyet përkatëse.

3.2 Në rastet kur dokumentacioni i paraqitur nuk është i plotë, Banka e Shqipërisë, njofton bankën brenda 10 ditëve. Mangësitë duhet të plotësohen nga banka brenda 15 ditësh pune.

3.3 Miratimi ose refuzimi i emërimit të ekspertit kontabël të autorizuar bëhet nga Administratori i Bankës së Shqipërisë.

Neni 4

Kontrolli i raporteve financiare

4.1 Eksperti kontabël i autorizuar nga Banka e Shqipërisë kontrollon nëse raportet financiare të bankës janë përgatitur në përputhje me "Standardet ndërkombëtare të kontabilitetit", përveç kur është parashikuar ndryshe në ligjin "Për kontabilitetin" dhe në "Manualin e kontabilitetit bankar".

Këto raporte përfshijnë:

- llogarinë e humbje-fitimit (pasqyra e të ardhurave dhe e shpenzimeve);
- bilancin kontabël;
- raportin për ndryshimet në kapital;
- pasqyrën e cash flow-t;
- shënimet që shoqërojnë raportet financiare.

4.2 Kontrolli i raporteve financiare, sipas pikës 4.1 të këtij neni, kryhet në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore për ekspertizën kontabël dhe me standardet ndërkombëtare të kontrollit.

4.3 Mbi bazën e ekzaminimit të bërë, sipas pikës 4.2 të këtij neni, eksperti kontabël i autorizuar jep një opinion, duke vënë në dukje nëse raportet financiare përfaqësojnë një pamje të vërtetë dhe të saktë të aktiveve, të detyrimeve, të kapitalit, të cash flow-t etj.

4.4 Gjatë planifikimit dhe kryerjes së kontrollit të raporteve financiare, eksperti kontabël i autorizuar vendos, në mënyrë të pavarur, mbi mënyrën e shqyrtimit të çdo dokumenti dhe të transaksioneve të biznesit, në mënyrë që të japë një opinion të saktë mbi vërtetësinë dhe rregullshmërinë e raporteve financiare të kontrolluara prej tij.

Neni 5

Opinioni i ekspertit kontabël të autorizuar

5.1 Në bazë të kontrollit që i ka bërë raporteve financiare për vitin ushtrimor, eksperti kontabël i autorizuar përgatit raportin përkatës mbi këtë kontroll, të ushtruar në përputhje me kërkesat e legjislacionit për ekspertizën kontabël dhe standardet ndërkombëtare të kontrollit (ISAs), dhe ia dorëzon këtë raport drejtuesve të bankës.

5.2 Drejtuesit e bankës i paraqesin asamblesë së zakonshme të aksionerëve raportet financiare të vërtetuara nga eksperti kontabël i autorizuar së bashku me opinionin e tij. Drejtuesit e bankës nënshkruajnë raportet financiare të vërtetuara nga eksperti kontabël i autorizuar.

5.3 Pas marrjes së vendimit përkatës nga asambleja e aksionerëve, sipas përcaktimit të bërë në pikën 5.2 të këtij neni, banka boton në buletinin zyrtar të saj bilancin kontabël, raportin vjetor financiar dhe raportin e ekspertit kontabël të autorizuar.

5.4 Një kopje e buletinit zyrtar të bankës, të botuar sipas pikës 5.3 të këtij neni, dërgohet edhe në Bankën e Shqipërisë, jo më vonë se gjashtë muaj nga përfundimi i periudhës raportuese.

Neni 6

Vlerësimi i pasqyrave financiare me karakter specifik

6.1 Eksperti kontabël i autorizuar shqyrton dhe vlerëson pasqyrat financiare të bankës, të cilat tregojnë gjendjen në fund të vitit financiar dhe/ose të periudhave të tjera të ndërmjetme gjatë vitit në vazhdim. Këto pasqyra financiare përgatiten nga banka në përputhje me aktet nënligjore të Bankës së Shqipërisë dhe përfshijnë të gjitha pasqyrat e sistemit raportues të bankave.

6.2 Vlerësimi i pasqyrave financiare, sipas pikës 6.1 të këtij neni përfshin:

a) verifikimin e saktësisë së pasqyrave të përgatitura në përputhje me aktet nënligjore të Bankës së Shqipërisë, që rregullojnë mënyrën e përgatitjes së tyre;

b) verifikimin e përputhjes së pozicioneve kyçe korresponduese në pasqyrat financiare me ato në raportet financiare, sipas nenit 4 të kësaj rregulloreje.

6.3 Në rastet kur eksperti kontabël i autorizuar nuk mund të japë një vlerësim mbi bazën e rezultateve të arritura nga ekzaminimi i pasqyrave financiare, ai bën komente mbi çdo pasqyrë për të cilën nuk mund të jepet vlerësim pozitiv, dhe paraqet parregullsitë e vërejtura në pasqyrën në fjalë.

6.4 Eksperti kontabël i autorizuar dorëzon vlerësimin e tij me shkrim tek drejtuesit e bankës për vlerësimin e pasqyrave financiare të përcaktuara në këtë nen.

6.5 Pasqyrat financiare, të përgatitura në përputhje me aktet nënligjore të Bankës së Shqipërisë, së bashku me raportin/vlerësimin e ekspertit kontabël të autorizuar sipas pikës 6.4 të këtij neni paraqiten nga drejtuesit e bankës në Bankën e Shqipërisë jo më vonë së 6 muaj mbas përfundimit të periudhës raportuese.

6.6 Çdo pasqyrë financiare e bankës do të jetë e nënshkruar paraprakisht nga drejtuesit e bankës.

Neni 7
Procedura të tjera kontrolli

7.1 Eksperti kontabël i autorizuar bën edhe vlerësimin e mjaftueshmërisë dhe të cilësisë të akteve nënligjore dhe të procedurave të bankës dhe zbatimin e tyre. Kjo përfshin vlerësimin, nga ana e ekspertit kontabël të autorizuar, për:

a) organizimin dhe efektivitetin e sistemit të kontrollit të brendshëm të bankës;

b) cilësinë dhe zbatimin e rregulloreve të brendshme të bankës për administrimin e aktiveve dhe pasiveve;

c) organizimin e sistemit të teknologjisë së informacionit dhe koordinimin e tij me objektivat e biznesit dhe me ruajtjen e integritetit të të dhënave.

7.2 Eksperti kontabël i autorizuar përgatit një raport, në të cilin shpreh opinionin dhe vlerësimin e tij, mbi rezultatet e nxjerra për organizimin dhe efektivitetin e kontrollit të brendshëm të bankës dhe mbi cilësinë e rregulloreve të bankës dhe zbatimin e tyre, të cilin e dorëzon tek drejtuesit e bankës dhe një kopje të tij edhe në Bankën e Shqipërisë, jo më vonë se 6 muaj mbas përfundimit të periudhës raportuese.

Neni 8
Dispozita përfundimtare

8.1 Eksperti kontabël i autorizuar i bankës, i miratuar nga Banka e Shqipërisë, kryen kontrollin në bankë për një periudhe jo më të gjatë se tre vjet në vazhdim nga momenti i miratimit të tij, në përputhje me dispozitat e kësaj rregulloreje.

8.2 Sipas kërkesës së bërë nga Banka e Shqipërisë, drejtuesit e bankës paraqesin për dijeni në Bankën e Shqipërisë "Letrën për administrimin", që eksperti kontabël përgatit për drejtuesit e lartë të bankës.

8.3 Eksperti kontabël i autorizuar informon Bankën e Shqipërisë për çdo veprim mashtrues të kryer nga nëpunësit e bankës, si dhe për parregullsitë dhe mangësitë në administrim ose në transaksionet që mund t'i sjellin bankës humbje.

8.4 Përfaqësues të Bankës së Shqipërisë (Departamenti i Mbikëqyrjes), eksperti kontabël i autorizuar dhe përfaqësues të bankës zhvillojnë takime të rregullta periodike:

- para ose pas përfundimit të ekzaminimit të plotë të kryer nga mbikëqyrësit e bankës;
- në rrethanat kur merren vendime të rëndësishme për bankën.

8.5 Udhëzimi "Për ekspertët kontabël të autorizuar të bankave dhe të degëve të bankave të huaja", miratuar me vendimin nr. 39, datë 16.5.2001 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, shfuqizohet.

8.6 Kjo rregullore u miratua me vendimin nr.6, datë 29.1.2003 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë dhe hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.

KRYETARI
Shkëlqim Cani

Fletorja Zyrtare gjendet:

- në çdo njësi postare të çdo qyteti;
- pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare:
Rr. Qemal Stafa, pranë ndërtesës së Prokurorisë së Përgjithshme.

Pranë **Qendrës së Publikimeve Zyrtare** mund të gjeni:

Kodi Penal

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Mars, 2002

Kodi i Procedurës Penale

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Shtator, 2002

Kodi i Procedurës Civile

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Korrik, 2002

Kodi Rrugor

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Qershor,2002

Kodi Penal Ushtarak

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Tetor, 2002

Përmbledhëse legjislacioni në fushën e Përmbarimit

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Tetor, 2002

U dorëzua për shtyp më 6.2.2003
Doli nga shtypi më 7.2.2003

Tirazhi: 4250 copë	Formati: 60x88/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2003

Çmimi: 100 lekë